



Edukimi përmes Artit Social



Autor: Elisa Bano, Lorela Musta

Grafist: Elisa Bano

Redaktim: Anila Mema

*Ky Booklet u realizua në kuadër të projektit "Edukimi përmes Artit Social"
nga Zendra STEPS me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës*

Qershor, 2019

Erjon Ibrahim

Erlis Sylaj

Renato Cenaj

Lisjana Buzi

Artemis
Hasandoçaj

Dedikuar nxënësve të Institutit "Ramazan Kabashi", të cilët me dashurinë, këmbënguljen, dhe gjithë nuancat e ngjyrave të tyre na kanë mësuar të shohim përtej limiteve.

Kejda Hysa

Marjana Abazi

Silvana Caka

Ebesardo Taçi

Marie Bila
Kleisi Bunguri



Our task, regarding creativity, is to help children climb their own mountains, as high as possible. No one can do more.
- Loris Malaguzzi

Çfarë është Mjeshtëria Sociale?

Mjeshtëria Sociale e ndeshur gjerësisht me termin Social Artistry është arti i rritjes së kapaciteteve njerëzore duke marrë parasysh kompleksitetin social. Synimi kryesor është që të sjell mënyra të reja të menduari, për të arritur sfida sociale në botë.

Duke mbështetur trajnimin e liderave në shumë organizata, fusha dhe vende të ndryshme, Social Artistry sjell përdorimin e artit në ngritjen e kapaciteteve njerëzore për të arritur transformim social.

Artistët Social janë lidera në shumë fusha dhe përcjellin të njëjtin pasion dhe aftësi në telajon e realitetit social sikurse artistët sjellin përmes artit të tyre.

Çdo gjë ka të bëjë me krijimin e ndryshimeve sociale dhe njerëzore duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin dhe me qëllimin për të ndërtuar një botë më të mirë.

Projekti “Edukimi përmes Artit Social” projekt i iniciuar nga Qendra STEPS dhe i mbështetur nga Ministria e Kulturës, ka në fokus edukimin e nxënësve me vështirësi në shikim (Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë), nëpërmjet metodës socio-artistike duke zhvilluar kapacitetet artistike në pikturë, punime në baltë dhe handmade.



Mbi projektin “Edukimi përmes Artit Social”

Projekti “Edukimi përmes Artit Social” ka lindur si pjesë e programit Social Artistry “Colorful People” i cili aplikohet përmë shumë se dy vjet në Institutin Ramazan Kabashi - Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë (INNSH), Tiranë, institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Ky institut edukon dhe akomodon rreth 60 fëmijë që vijnë nga zona të ndryshme të Shqipërisë dhe që kanë vështirësi në shikim ose nuk arrijnë të shohin plotësisht.

Në këtë program janë përfshirë rreth 10 fëmijë të grupmoshës 8-15 vjeç. Fëmijët që janë pjesë e këtij programi i përkasin grupit të fëmijëve që kanë vështirësi në shikim. Përveç kësaj, ata janë përzgjedhur pasi kanë shfaqur talent në vizatim dhe pikturë, dhe një përkushtim dhe interes të lartë në këtë fushë.

Ky program zhvillohet në ambjentet e këtij instituti nga një grup vullnetarësh të Qendrës STEPS (student dhe profesionistë në fushën e pikturës dhe psikologjisë).

Synimi kryesor i këtij programi është përfshirja sociale e fëmijëve me vështirësi në shikim, përmirësimi i aftësive dhe mësimi i teknikave artistike në pikturë/handmade, mbështetja emocionale dhe ndërtimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse.



Çfarë është arritur gjatë këtij programi?

Gjatë këtij programi është arritur:

- zhvillimi i aftësive artistike të nxënësve në vizatim dhe pikturë;
- zhvillimi i aftësive artistike të nxënësve në punimet hand-made;
- nxitja dhe zhvillimi i të menduarit kreativ;
- përmirësimi i gjendjes emocionale;
- nxitja e aktivizimit rinor dhe promovimi i vullnetarizmit;
- krijimi i bashkëpunimeve të suksesshme midis OJF-ve dhe institucioneve shtetërore;
- promovimi i aftësisë ndryshe me fokus në talent dhe jo në limite;
- rritja e ndërgjegjësimit social mbi promovimin e talenteve të grupeve të marxhinalizuara.


përtej zhvillimit të aftësive artistike

Aktivitetet artistike që kanë të bëjnë me shprehjen e kreativitetit e ndihmojnë individin në rritjen e sensit për veten, përballjen me stresin dhe eksperiencat traumatike, zhvillimin e aftësive motorike dhe zgjerimin e aftësive konjitive.

Arti i ofron fëmijës një mundësi për të komunikuar. Procesi i vizatimit në të vërtetë i ofron fëmijës një formë tjetër komunikimi, jo-verbale dhe simbolike, nëpërmjet të cilës ai mund të shpreh edhe në mënyrë të pandërgjegjshme, ndjenjat, dëshirat, frikat dhe fantazitë e botës së tij të brendshme.

Gjatë punës me fëmijët me vështirësi në shikim është e rëndësishme që t'i mbështesim në çfarë fëmijët kanë nevojë të shprehin dhe t'i pyesim vazhdimisht për atë çfarë paraqesin pikturat e tyre. Duhet t'i inkurajojmë kur ndjejnë se nuk po vizatojnë apo pikturojnë ashtu siç duan, pa ndërhyrë ne në pikturën e tyre, por duke kuptuar nevojën e fëmijës për të qenë i vlerësuar. E rëndësishme është emocioni që transmetojmë dhe jo të qenit perfekt.

Një artist social përballet gjithashtu me rëndësinë për t'i menaxhuar fëmijët në grup. Dinamikat në grup, situatat mes bashkëmoshatarëve dhe konfliktet mes tyre, janë një nga sfidat me të cilën një artist social përballet gjatë punës së tij. Aftësitë e tij si lider dhe aftësitë për të kuptuar nevojat e secilit prej fëmijëve e bëjnë atë të kapërcej këto situata dhe të nxisë marrëdhëniet pozitive dhe bashkëpunimin ndërmjet fëmijëve.



EKSPOZITA

Ekspozitat me punimet e realizuara në kuadër
të programit

Dita Ndërkombëtare e Muzeve.

Muzetë: Një realitet për njerëzit me aftësi ndryshe

19/05/2018

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Qendra STEPS ishte e ftuar në aktivitetin me temë “Muzetë: Një realitet për njerëzit me aftësi ndryshe” ku u prezantua me punën disa vjeçare të programit Social Artistry “Colorful People”, shoqëruar edhe me një ekspozitë me piktura në ambjentet e Muzeut Historik Kombëtar të realizuara gjatë këtij programi.



Ekspozita “Colorful People”

01/06/2018

Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Institutin “Ramazan Kabashi” (INNSH - Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë) në kuadër të programit vullnetar Social Artistry “Colorful People”.

Në këtë ekspozitë u paraqitën pikturat, telajot, punimet hand-made të realizuara nga një grup i nxënësve të INNSH gjatë programit Social Artistry “Colorful People”.

Ekspozita “Colorful People”

13/12/2018

Kjo ekspozitë u realizua në ambjentet e Institutit “Ramazan Kabashi” (INNSH - Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë) si shenjë mikpritje për nxënësit e klasës së tretë të shkollës Turgut Ozal të shoqëruar nga mësuesja e tyre dhe drejtori i shkollës.

Synimi i këtij bashkëpunimi ishte që nxënësit të njohin më tepër njeri-tjetrin por edhe të shihnin se sa të talentuar janë nxënësit e INNSH.



Ekspozita “Colorful People”

18/12/2018

Kjo ekspozitë u realizua në ambjentet e Institutit “Ramazan Kabashi” (INNSH - Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë) me rastin e festave të fundvitit duke i dhënë një pamje më mikpritëse ambjentit të institutit.

Ekspozita “Duart e tua më ndihmojnë të pikturoj të ardhmen”

19-20/10/2018

Në bashkëpunim me Agjensinë NBS u realizua pranë Sheshit Avni Rustemi ekspozita “Duart e tua më ndihmojnë të pikturoj të ardhmen” ku fëmijët e Institutit “Ramazan Kabashi” ekspozuan punimet e tyre në pikturë dhe handmade të realizuara gjatë programit Social Artistry “Colorful People”. Ky bashkëpunim afroi më pranë nxënësit e INNSH me artizanë të cilët sollën mbështetje profesionale, inkurajim dhe bashkëpunim të mëtijshëm në mbështetjen e talentit të nxënësve të INNSH.



Ekspozita “Colorful People”

07/03/2018

Kjo ekspozitë u realizua në ambjentet e Institutit “Ramazan Kabashi” (INNSH - Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë) me rastin e festës së mësuesit (7 Marsi) duke i dhënë një pamje më mikpritëse ambjentit të institutit.

Album







Çfarë është një Artist Social?

“Artisti Social është gjatë gjithë jetës një nxënës në artin e marrëdhënieve interpersonale. Ata janë në gjendje të gjejnë mënyra për të kapërcyer barrierat e mëdha që i ndajnë nga të tjerët dhe janë në gjendje të kapërcejnë stereotipet dhe t’i shohin dhe ti respektojnë të tjerët thellësisht.”

-Jean Houston



Një artist social është një individ i cili ofron mundësi sociale për të mësuar përmes përdorimit të artit. Një artist social të fton që të përfshihesh - është dëgjues i mirë, shfaq empati, vlerëson dhe gjithashtu bënë pyetje që do të krijojnë hapësirën sociale të nevojshme për të mësuar. Gjithashtu, ai përdor mënyra kreative duke u bazuar në metodën e edukimit joformal, me qëllim arritjen e rezultateve që sjellin ndryshime në shoqëri.

Vullnetarët



Klarita Ceka

Studente - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës,
Dega Arkitekturë

Nëse dikush do të më thoshte se do të lidhesha kaq shumë me disa fëmijë të vegjël që nuk i njihja aspak, nuk do ta besoja.

Por, kështu ndodhi me mua dhe fëmijët e Institutit. Gjatë këtyre dy viteve ata më kanë mësuar dhe më kanë rritur shumë. Më treguan se sa shumë vlerë ka një buzëqeshje, një përqafim apo një tela e vogël me ngjyra. Më mësuam sesa gëzon një shpirt kur është i lirë e bën atë çfarë do, sesi bota jonë është kaq e vogël para zemrave të fëmijëve.

Kështu presim në çdo javë, vullnetarët dhe fëmijët, për pak orë mes nesh, disa të qeshura më shumë dhe ëndrra që pluskojnë në dhomën tonë të punës.

Nëse duhet të ruajmë diçka nga jeta jonë, ato janë momentet e bukura nga fëmijëria jonë dhe do sigurohem që tek këta fëmijë ndër to kujtime, të jemë dhe ne.

Anora Kroj

Psikologe - MSc. Psikologji Klinike

Përvoja e punës edhe aktiviteti me fëmijët në shkollën Ramazan Kabashi ka qenë nga ato përvoja që të mbeten gjatë në kujtesë. Kam qenë vullnetare tek kjo nisëm për afro dy sezonesh, edhe kjo përfshirje më ka dhënë një eksperiencë shumë të mirë e të vlefshme me fëmijët. Ajo çfarë medoja se duhet të investoja gjatë kohës që ata pikturonin, ishte vetëbesimi. Ata fëmijë kanë një talent shumë të veçantë edhe se bashku me mbështetjen edhe vetëbesimin mundëm të bënim gjëra të mira.

Puna edhe koha që kalova në këtë aktivitet është e vlefshme për mua pasi më mësoi më shumë sesi të menaxhosh kreativitetin, grupin, sesi të shfaqësh edhe pikturosh ndjesitë e një fëmije në tela. Gjithashtu, kam konsideratë shumë të mirë për të gjithë stafin shumë të përgatitur edhe mbi të gjitha shumë human.





Bora Dollanga
Cicerone arti, Galeria Kombëtare e Arteve



Desara Tafa
Studente - Fakulteti i Mjekësisë,
Dega Shëndet Publik



Elisa Arapi
Studente - Fakulteti i Shkencave Sociale, Dega Psikologji

Viti i parë te "Instituti Ramazan Kabashi" dhe jam ndjerë si në shtëpi. E kam ndjerë dashurinë e fëmijëve që në ditë të parë. Në fillim mendoja se do lodhesha e s'do ja dilja duke parë ngarkesën që kisha në shkollë, po realisht unë mezi prisja ditën e institutit. Duke parë talentet e tyre jam befasuar e jam rikthyer dhe vet në fëmijërinë time. Fëmijët i dua shumë dhe përherë përshtatem me ta, e shpresoj të gjejë kohën e pse jo ta vazhdoj për shumë gjatë këtë eksperiencë.



Fjoralba Pepa
Psikologe - MSc. Psikologe Organizacionale



Kevin Gaxhja
Student - Fakulteti i Arkitekturës dhe
Urbanistikës, Dega Arkitekturë



Rei Selimaj
Student - Fakulteti i Arkitekturës dhe
Urbanistikës, Dega Arkitekturë

Besa Biti

Sara Laze

Denisa Oruçi

Brunilda Pulaj

Enis Kalemi

Ky Booklet u përgatit në kuadër të projektit “Edukimi përmes Artit Social” të realizuar nga Qendra STEPS në Institutin “Ramazan Kabashi” (Instituti i Nxënësve që Nuk Shikojnë), me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës.

